

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018“ dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

### **KONKURS**

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe për zgjedhjen-rizgjedhjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe për zgjedhjen-rizgjedhjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

#### **FAKULTETI JURIDIK**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin E drejta ndërkombëtare private (50807 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin E drejta ndërkombëtare publike, Liritë dhe të drejtat e njeriut (50806, 50818 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

#### **FAKULTETI FILOLOGJIK**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Gjermanistikë (Hyrje në gjuhësi, Historia dhe kultura e vendeve gjermanishtfolëse), Metodika e gjuhës (Hyrje në metodikën e mësimdhënies së gjuhës gjermane, Metodika e mësimdhënies së gjuhës gjermane), (64005, 64028 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një asistent në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Historia e letërsisë së popujve romanë (Letërsi frënge), Mësimi i gjuhëve të huaja (Gjuhë frënge), (61211, 64021 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
3. Një lektor në lëmin Gjermanistikë (64005 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

#### **FAKULTETI FILOZOFIK**

1. Një asistent në lëmin Psikologjia organizacionale, Psikologji arsimore dhe e edukimit (51008, 51005 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një asistent në lëmin Filologji orientale dhe tjera (64008 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

## **FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA**

1. Tre asistentë në lëmin Projektimi arkitektonik dhe dizajn (20100 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një asistent në lëmin Konstrukione arkitektonike (20112 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
3. Një asistent në lëmin Planifikimi dhe projektimi urban dhe hapësinor (20114 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
4. Një asistent në lëmin Inxhinieria e tërmeteve (20703 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike;
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

### **Kushtet për thirrjen e bashkëpunëtorit:**

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorëve, të parapara me nenet 166 dhe 170 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**